

Ne fokus/ Tifozet e Kukësit ironizojne FSHF-ne

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 14 Dhjetor 2013 21:35



Tifozet e Kukësit kanë lënë protestat në qytet dhe i kanë zhvendosur ato në stadiumin e Durrësit. Në ndeshjen me Teutën, kanë qenë me shumë se një mijë tifoz nga Kukësi të cilët kanë perkrahur skuadrën e tyre. Po rëndësishëm kanë menduar edhe për të vazhduar protestën e tyre. "RIP FSHF". Kjo ka qenë parrulla e tifozëve të Kukësit për atë që i dënuan skuadrën e tyre me tre pike me pak. Javën e ardhshme, tifozet e Kukësit kanë planifikuar të tjera protesta duke mos hequr dorë nga e drejta e tyre dhe bëjnë presion që Komisioni i Apelit të falë dhe të anulohet vendimi i Disiplinës.